

**VENDIM**  
**Nr.362, datë 19.5.2010**

**PËR AKORDIM FONDI KOMUNËS MBROSTAR TË QARKUT TË FIERIT PËR  
DHËNIE NDIHME FINANCIARE FAMILJES SË SHTETASIT EDMOND MOÇKA,  
PUNONJËS POLICIE, ZJARRFIKËS, I CILI RA NË KRYE TË DETYRËS PËR TË  
SHPËTUAR JETËT E NJERËZVE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5 e 45 të ligjit nr.9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, dhe të nenit 13 të ligjit nr.10 190, datë 26.11.2009 “Për buxhetin e vitit 2010”, me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

1.Komunës Mbrostar të qarkut të Fierit, në buxhetin e vitit 2010, t’i akordohet fondi prej 2 000 000 (dy milionë) lekësh, për t’iu dhënë si ndihmë financiare familjes së shtetasit Edmond Moçka, punonjës policie, zjarrfikës, i cili ra në krye të detyrës për të shpëtuar jetët njerëzore, në datën 11.5.2010.

2.Ky fond të përballohet nga fondi rezervë i Buxhetit të Shtetit.

3.Ngarkohen Ministri i Financave, Ministri i Brendshëm, prefekti i qarkut të Fierit dhe komuna Mbrostar për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYEMINISTRI**  
**Sali Berisha**